



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050976

Datë: 02.08.2021

Numri i dokumentit: 02051425

C.nr.1011/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Kaltrinë Haliti, në çështjen kontestimore të paditësit Z. U. nga fshati Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Milot Spahiu avokat nga Gjilani, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit– Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson me autorizim Burim Maliqi, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve për ushqim gjatë punës dhe shpenzimet të udhëtimit, vlera e kontestit 1,984.50 € pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, të mbajtur me datë 12.07.2021, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. U. nga fshati Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit Z. U. nga fshati Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë përkatësisht shumën në lartësi prej 459€, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021 (667 ditë) nga 2€ në ditë t’ia paguaj shumën në lartësi prej 1,334.00€, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 667 ditë pune nga 1.00€ apo 70% të bilëtes së trafikut urban shumën prej 466.90€, shumën e përgjithshme prej 2,259,90€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë shumën në lartësi prej 270€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m i

Fillimisht paditësi Z. U. nga Gjilani, nga fshati Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë më datë 10.04.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimeve për ushqim gjatë punës si dhe kompensimin e udhëtimit duke kërkuar nga gjykata shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,984.50. Mirëpo në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.07.2021 ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin objektiv përkatësisht e ka zmadhuar kërkesëpadinë sa i përket ditëve të pranisë në punë për kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit, ashtu që tani e tuje ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit Z. U. t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar mbi 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë, shumën në lartësi prej 459€, në emër të kompensimit të

shpenzimeve për ushqim gjatë punës për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,334.00€ (për 667 ditë pune) si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 667 ditë punë nga 0.70€ apo 70% të bilëtes së trafikut urban shumën prej 466.90€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 2,259,90€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, ndërsa pjesa tjetër e petitumit të kërkesëpadisë sa i përket shpërblimit jubilar mbetet e pandryshuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas pranimit të padisë duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi. Me të cilin e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë me dt. 17.11.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës (në vijim: KPKK) të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 6 dhe 7 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti i dt.06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Po ashtu e njëjta konsideron se gjykata themelore në Gjilan në këtë çështje juridike nuk kompetencës lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje. Si arsye tjetër ka cekur se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Po ashtu i njëjti është thirrë edhe në parashkrim të kërkesës nga se sipas Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Ligji Nr.04/L-077 neni 353 par.3 dhe neni 357 par.1 si dhe sipas Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 87 kemi parashkrim të lëndës për arsye se tash më paditësi ka 33 vite përvojë të punës që do të thotë një kërkesë të tillë e ka bërë pas 3 viteve, e që kjo vërtetohet edhe përmes listës së pagëve të cilën paditësi e ka sjellë si provë të bashkangjitura me padi.

Në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me dt. 12.07.2021 përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse i propozuan gjykatës që për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës të kalohet drejtpërdrejtë në seancë kryesore, gjykata e pranoi propozimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ashtu që konform nenit 420.3 të LPK-së, për shkak të ekonomizimit, efikasitetit të procedurës e gjithashtu për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes kaloi drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor të çështjes.

I autorizuari i paditëses si në seancën përgaditore, kryesore po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe ndryshimit të kërkesëpadisë në kuptimin objektiv në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën 12.07.2021, sa i përket ditëve të punës dhe kompensimit të udhëtimit, duke i rritur kërkesat e tij, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komonale e Arsimit në Gjilan që paditësiit Z. U., t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar mbi 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë shumën në lartësi prej 459€, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,334.00€ (për 667 ditë pune) si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 667 ditë punë nga 0.70€ apo 70% të bilëtes së trafikut urban shumën prej 466.90€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 2,259,90€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Gjithashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë 104 € për i hartimin e padisë, për taksë gjyqësore 31€ si dhe për një seancë gjyqësore shumë prej 135€ .

Përfaqësuesi i të paditurës, si në seancën e shqyrtimit kryesor poashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si dhe ndryshimin e saj të bërë gjatë shqyrtimi gjyqësor si të pathemeltë, ngase Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese Kontratës Kolektive të Arsimit dhe se e njëjta nuk prodhon efekte juridike ndaj saj. Ka shtuar se nuk kërkon afat shtesë për të deklaruar lidhur me ndryshimin e kërkesëpadisë, e poashtu i kundërshton edhe kërkesat lidhur me shpenzimet e ditëve të punës dhe shpenzimet e rrugëtimit pas datës 18.04.2020, sepse këto ditë janë të llogaritur pas skadimit të afatit të Kontratës Kolektive. Po ashtu i njëjti e ka kontestuar edhe pagën jubilarë ngase në rastin konkret kemik parashkrim të kërkesë sipas LMD-ës dhe Ligjit të Punës. Në fund ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale dhe atë: Kontratën e punës për kohë të pacaktuar e dt. 01.09.201, Vërtetimin me nr. 776 të datës 27.10.2020 mbi përvojën e punës, Listën e pagave me nr. EM00016175, Certifikatën e vendbanimit me nr. B 102623, Kuponin fiskal me nr.7, Formularin për kërkesë me nr. 05-610/01-00112605/20 i dt, 03.02.2020, Vërtetimin e SHMT “Mehmet Isai” në Gjilan i dt.28.02.2020, Vërtetimin nga SHTU “Anamorava” në Gjilan i dt.10.06.2021 dhe Vërtetimin e SHMT “Mehmet Isai” në Gjilan i dt.17.06.2021.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata e aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e dt. 01.09.2018 me nr. të protokollit 354, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie të rregullt pune në kohë të pacaktuar në Shkollën e Mesme Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan dhe i njëjti që nga data 01.09.2018 në këtë shkollë punon si Mësimdhënës i lëndëve të Makinerisë.

Nga Vërtetimi me nr. 776 i datës 27.10.2020 mbi përvojën e punës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka filluar të punoj si mësimdhënës që nga data 01.09.1982 dhe vazhdon të punoj edhe më tutje dhe ka përvojë pune mbi 35 vite.

Nga Lista e pagave me nr. EM00016175 gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën neto e ka 540.27 € ndërsa pagën bazë e ka 459€.

Nga Certifikata e vendbanimit me nr. B 102623, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është banor i fshatit Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit ku edhe i njëjti e ka vendbanimin e tij.

Nga Formulari për kërkesë me nr. 05-610/01-00112605/20 i dt, 03.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti fillimisht i është drejtuar Komunës së Gjilani për realizimin e kompensimit të ushqimit dhe kompensimit të udhëtimit.

Nga Vërtetimi i SHMT “Mehmet Isai” në Gjilan i dt.28.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Z. U. gjatë vitit 2016/17, 2017/18, 2018/19, 2019/20 ka gjithësejt 539 ditë pune e gjithashtu edhe faktin se SH.M. T „Mehmet Isai,, nuk posedon kuzhinë apo reastaurant për ushqim të punsuarve.

Nga Vërtetimi i SHMT “Mehmet Isai” në Gjilan i dt.17.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Z. U. gjatë vitit 2020/21 ka gjithësejt 128 ditë pune, e gjithashtu edhe faktin se SH.M. T „Mehmet Isai,, nuk posedon kuzhinë apo reastaurant për ushqimine të punsuarve.

Nga Vërtetimi nga SHTU “Anamorava” në Gjilan i dt.10.06.2021, gjykata vërtetoi faktin se bileta e udhëtimit në relacionin Livoç i Epërm-Gjilan kushton 0.50 euro.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017 ku shprehimisht është përcaktuar se *“punëtorët(anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilar të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë....: kurse pika 8.1 parasheh, për 10 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë 50% të një page bazë, pika 8.2 parasheh se për 20 vite të përvojës së punës përfiton shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej 75% të pagës bazë dhe 8.3 ku parashihet se:” Punëtorët (antarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë”. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”, në nenin 35 paragrafi 5. i Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017, është paraparë se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë ipaguhen shpenzimet e rregulluara 70% të biletave të trafikut urban”, dhe në nenin 37 paragrafi 7 është parapar se “Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditën e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy), euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit e kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, gjykata në bazë të dispozitave të lartcekura dhe pas vërtetimit të faktit se paditësi Z. U. te e paditura ka punuar fillimisht në Shkollën fillore në fshatin Bresalc e që nga data 15.09.2003 në SHFMT “Mehmet Isai” në Gjilan në pozitën e mësimeve të lëndëve të Makinerisë, ku vazhdon të punoj edhe më tutje në të njëjtën pozitë, ndërsa prej datës 18.04.2017 e deri më dt.18.04.2020 i ka 667 ditë pune dhe të njëjtit i takojnë dy euro në ditë për shujtë ditore, andaj mbi këtë bazë e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e tij në lartësi prej 1,334.00 € ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 667 ditë pune nga 1 euro në ditë apo 70% të biletave të trafikut urban shumë e të hollave në lartësi prej 466.90€,e poashtu pasi që i njëjti ka përvojë pune mbi 30 vite, të njëjtit i takon shpërblimi jubilar në vlerë të një page bazë në lartësi prej 459 €, respektivisht shumë e përgjithshme prej 2.259.90 €, andaj mëqë në rastin konkret u vërtetua gjendja faktike siç është potencuar më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.**

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se *„Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për çështje*

Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket të çështjeve të punëdhënsit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t'i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e Komuniteteve sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. Gjithashtu është i pabazuar edhe pretendimi i të paditurës se në rastin konkret paditëses i mungon baza ligjore pasi që kjo çështje është e rregulluar me Ligjin e punës gjegjësisht neni 90.1,2,3,4,5,6 të po këtij ligji.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet dhe kundërshtimet e të autorizuarës të paditurës të cekura gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e mbajtur më datën 12.07.2021, se paditëses nuk i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë dhe kompensimi i shpenzimeve të rrugëtimit pas datës 18.04.2020, ditë këto të llogaritura sipas vërtetimit të dt.17.06.2021, me arsyetimin se këto ditë janë të llogaritura pas skadimit të afatit të KKAK-së, por gjykata vlerëson se nuk qëndron një pretendim i tillë i të paditurës, pasi që me nenin 45 të KKAK, shprehimisht është paraparë se: *“Nga Kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmujorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”*. Në rastin konkret përderisa nuk kemi kontratë të re të nënshkruar nga palët ndërgjyqëse dhe nuk kemi tërheqje nga KKAK të asnjërës palë, bazuar nga neni i lartcekur i KKAK, mund të përfundohet se dispozitat e kësaj kontrate janë akoma në fuqi dhe kjo kontratë prodhon efekt juridik për palët kontraktuese, deri në nxjerrjen dhe nënshkrimin e kontratës së re kolektive apo siç është cekur më lartë zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit, e që bazuar edhe në Ligji i Punës, dispozitat e të cilit ligj, zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës, i cili ligj në nenin 90 parag. 6 ka paraparë edhe atë se: *“Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës së paditëses, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi padia në gjykatë është parashtruar me dt. 10.04.2020, pra pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë para kësaj date, pra, para dt.18.04.2017, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga këto arsye rezulton se padia e paditëses është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë, duke pasqyruar faktin se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së tij lidhur me kërkesën e parashtruar, i njëjti si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: *“Kreditoret në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij ”*, andaj, duke pasqyruar të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditëses, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t’ia kompensojë shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se *„Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën, kurse Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së ashtu që e aprovoi si të bazuar kërkesën e paditësit, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, dhe e detyrojë të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit për përpilimin e padisë nga avokati shumën prej 104 euro, për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej 31 euro, për përfaqësimin e paditëses nga avokati për një seancë gjyqësore shumën prej 135 euro, në shumën e përgjithshme prej 270€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 3, 22, 24, 31, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe në nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1011/20, dt.12.07.2021

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:050976
Datë: 02.08.2021
Numri i dokumentit: 02051425